

Vendim nr. 31 datë 20.02.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, në datën 20.02.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (H) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: HASAN ROQI

OBJEKTI: Saktësimi dhe plotësimi i vendimit nr. 224, datë 31.10.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 75 dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000); vendimi nr. 33, datë 08.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Hasan Roqi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesën e datës 05.08.2022 me objekt konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 314, datë 11.04.1994 të KKKP-së të dhënë në favor të trashëgimtarëve të shtetasit Xh.K., me të cilët ai është në një konflikt gjyqësor për një pasuri të paluajtshme. Me vendimin nr. 177, datë 09.12.2022 (*vendim nr. 177/2022*) Mbledhja e Gjyqtarëve të kësaj Gjykate ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me argumentin se pretendimet e kërkuesit ishin haptazi të pabazuara.

2. Në datën 16.03.2023 kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës për saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 177/2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, për të cilën, kjo e fundit me vendimin nr. 119 datë 05.06.2023 ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare dhe pranimin e kërkesës për saktësimin e paragrafit 17 të atij vendimi.

3. Në vijim, në datën 09.08.2023 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës, duke parashtruar pretendime si në lidhje me mënyrën e vlerësimit të kërkesës së tij nga Mbledhja e Gjyqtarëve, ashtu edhe për moszekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 76, datë 08.11.2000 të Gjykatës Kushtetuese, që ka të bëjë me të drejtat e pretenduara për pasurinë e paluajtshme shtëpi banimi.

4. Me vendimin e ndërmjetëm të datës 30.10.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur ndarjen e kërimit të parë në objektin e ankimit kushtetues individual që kishte të bënte me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve kushtetues, regjistrimin e këtij kërkitimi në regjistrin e ankesave dhe korrespondencës dhe trajtimin e tij administrativisht sipas ligjit, si dhe vazhdimin e shqyrtimit paraprak për kërkitimet e tjera në objektin e ankimit kushtetues të tij. Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi ka vlerësuar se kërkesa është paraqitur në kuptim të nenit 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe se në rastin konkret nuk ndodhemi përpara ndonjërit prej rasteve të parashikuara nga kjo dispozitë, me vendimin nr. 224, datë 31.10.2023 (*vendim nr. 224/2023*) ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

5. Pasi ky vendim është publikuar dhe i është njoftuar palës, në datën 11.12.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për saktësimin dhe korrigjimin e tij, e cila është regjistruar me nr. 12 (H) 2023 të Regjistrit Themeltar. Në vijim, në datën 25.01.2024, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për saktësimin dhe korrigjimin e vendimit nr. 224/2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, e cila është regjistruar me nr. 3 (H) 2024 të Regjistrit Themeltar.

6. Bazuar në nenin 1 të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenin 19, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës (*Rregullorja*), me vendimin e datës 09.02.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur bashkimin e çështjeve në një të vetme me nr. 12 (H) 2023 të Regjistrit Themeltar dhe kalimin për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka kërkuar saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 224/2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, pa ndryshuar vendimin, në përputhje me standardin e arsyetimit të vendimit, në këto pjesë të tij:

7.1. *Paragrafi 2, rreshti 6* - emërtesa “Kolegji Penal” është referuar në mënyrë të gabuar, pasi çështja në fjalë është e natyrës civile.

7.2. *Paragrafi 4, rreshti 11* - pas shprehjes “Kundërshtim i veprimeve përmbartimore”, duhet të shtohet togfjalëshi “*ndaj vendimit nr. 2227 datë 08.10.1997 të Gjykatës*”

së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga vendimi nr. 76 datë 08.11.2000 i Gjykatës Kushtetuese.”.

- 7.3. *Paragrafi 13, rreshti 4* - shprehja “sipas tij” duhet të zëvendësohet me togfjalëshin “sipas dispozitës urdhëruese pika 9, shkronja ç, UKM nr. 3 datë 21.06.1993 “Për zbatimin e ligjit nr. 7698 datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve””.
- 7.4. *Paragrafët 2 dhe 3* – kërkuesi dhe familja e tij nuk janë bërë bashkëpronarë nga vendimi nr. 2227, datë 08.10.1997 i Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga vendimi nr. 489 datë 26.03.1998 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe vendimi nr. 76, datë 08.11.2000 i Gjykatës, por nga udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 21.06.1993 (UKM nr. 3/1993). Në kundërshtim me këtë akt, i cili parashikon afatin 1-vjeçar, shpërblimi nga familja Kadesha është bërë pas 11 vjetësh, 5 muajsh e 21 ditësh. Pas përcaktimit të pjesës të investimit nga gjykatat, kërkuesi rezulton të jetë bashkëpronar në 37% të pronës dhe ajo duhet të regjistrohej në përputhje me ligjin. Vonesa në ekzekutim i ka cenuar atij thelbin e së drejtave të parashikuara nga nenet 6, paragrafi 1 dhe 8 të KEDNJ-së. Gjykata ka hyrë në kompetencat e Këshillit të Ministrave, duke i hequr kërkuesit të drejtën e bashkëpronësisë. Gjithashtu, pavarësisht faktit se vendimi nr. 8996, datë 03.10.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ishte firmosur vetëm nga një prej gjyqtarëve, Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Apelit Tiranë nuk e morën parasysht këtë fakt, megjithëse një veprim i tillë ishte në kundërshtim me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Kjo e fundit ka interpretuar faktin se edhe qiramarrësit në banesat shtetërore mund të përfitonin të drejtën e privatizimit dhe rrjedhimisht kanë legjitimitim për ngritjen e padisë. Po kështu, jurisprudenca kushtetuese dhe ajo e Gjykatës së Lartë kanë pranuar faktin se kthimi i të drejtave të pronës nuk duhet të shkaktojë padrejtësi të tjera. E drejta e pronës së kërkuesit është cenuar si pasojë e falsifikimit të certifikatës së pronësisë nga familja Kadesha dhe nxjerrjes nga banesa, megjithëse kërkuesi ishte bërë bashkëpronar.
- 7.5. *Paragrafi 6* - Kërkuesi nuk është njoftuar nga Gjykata për përbërjen e Kolegjit të shqyrtimit paraprak të çështjes së tij dhe datën e gjykimit në vijim nga Mbledhja e Gjyqtarëve, e cila ka disponuar me vendimet nr. 177/2022 dhe nr. 119/2023. Kjo është një metodë e ndryshme nga gjykatat e zakonshme dhe nuk është parashikuar nga ligji nr. 8577/2000 dhe Kodi i Procedurës Civile. Njoftimi do t'i mundësonte kërkuesit të kërkonte përjashtimin e gjyqtarit I.T., i cili kishte gjykuar një çështje të kërkuesit në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke pranuar pagesën e

shpërblimit nga familja Kadesha pas 11.5 vjetësh, megjithëse ligji parashikonte afatin 1-vjeçar. Gjithashtu, atij iu mohua e drejta për të kërkuar përjashtimin e katër gjyqtarëve ndaj të cilëve kërkuesi kishte paraqitur kërkesë në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit për fillimin e procedimit disiplinor. Pavarësisht se këta gjyqtarë paraqitën kërkesë për dorëheqje nga shqyrtimi i çështjes së tij të regjistruar me nr. 9 (H) 2023 të Regjistrit Themeltar, Mbledhja e Gjyqtarëve nuk i pranoi kërkesat, por as nuk njoftoi paraprakisht kërkuesin për këtë procedurë. Për sa u përket kërkesave për përjashtim, ato nuk mund të gjykoreshin të veçuara, kur kërkuesi kishte kërkuar përjashtimin e 5 gjyqtarëve. Tre gjyqtarët e tjerë, për të cilët kërkuesi nuk ka kërkuar përjashtimin, nuk mund të merrnin vendim për kërkesat për përjashtim, por as për themelin e çështjes, pasi nuk plotësonin kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje. Po kështu edhe gjyqtari relator ka shkelur UKM-në nr. 3/1993. Gjithashtu, gjyqtarja tjetër E.T. ka ndikuar në vendimmarrjet e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 177/2022 dhe nr. 119/2023.

- 7.6. *Paragrafi 7* - Ndarja e kerkimit të parë në objektin e kërkesës nga Mbledhja e Gjyqtarëve për sa i përket së drejtës për shqyrtimin e ankimit për masë disiplinore të gjyqtarëve të Gjykatës, në kundërshtim me ligjin nr. 8577/2000 dhe nenin 7 të Kushtetutës, ka pasur qëllim fshehjen e cenimit të të drejtave të kërkuesit dhe familjarëve të tij. Gjykata ka marrë kompetencat e KPA-së në këtë rast, çka përbën veprë penale. Vendimi nr. 2, datë 22.12.2023 i kryetares së Gjykatës duhej të dilte para datës 25.04.2022, pasi në këtë mënyrë vendimet e mëpasshme të Mbledhjes së Gjyqtarëve duken qartazi të paragjykuara dhe janë të pavlefshme.
- 7.7. *Paragrafi 13* - Gjykata ka vendosur të rrëzojë UKM-në nr. 3/1993 që konsiderohet themeli i kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe vendimin e saj nr. 76/2000, duke shkelur të drejtat e kërkuesit dhe duke marrë kompetencat e Këshillit të Ministrave.
- 7.8. *Paragrafi 14* - UKM-ja nr. 3/1993 dhe vendimi nr. 76/2000 i Gjykatës janë bërë objekt kontrolli nga vendimet nr. 177/2022, nr. 119/2023 dhe nr. 224/2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe janë shkelur të drejtat e kërkuesit.
- 7.9. *Paragrafi 15* - Përmendja e afatit 18-mujor është e pasaktë, pasi megjithëse KPA-ja me vendimet nr. 2 datë 24.01.2022 dhe nr. 3, datë 25.01.2022 ka vendosur moskompetencën për procedimin disiplinor të gjyqtarëve, Gjykata kishte kohë të mjaftueshme për të shqyrtuar kërkesat dhe nuk mund t'i arkivonte ato.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

8. Neni 133, pika 1, i Kushtetutës dhe neni 31 i ligjit nr. 8577/2000 përcaktojnë se çdo ankim kushtetues individual i nënshtrohet fillimisht fazës së shqyrtimit paraprak të kërkesës, ku vlerësohet nëse kërkesa e paraqitur duhet të pranohet për gjykim në seancë plenare. Në përputhje me këtë dispozitë kushtetuese, rregullat e detajuara të procedurave të gjykimit kushtetues përcaktohen nga ligji nr. 8577/2000 dhe Rregullorja, të cilat kanë parashikuar në dispozita të posaçme edhe kërkesat/ankesat ndaj vendimeve të gjykimit kushtetues. Në kuptim të këtyre parashikimeve, një prej rasteve në të cilin mund të vihet në lëvizje Gjykata për të shqyrtuar vendimmarrjet e saj, është kur kërkohet saktësimi dhe plotësimi i vendimit me qëllim ndreqjen e gabimeve në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar, por pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes (*neni 80 i ligjit nr. 8577/2000*). Ky parashikim është detajuar edhe në nenin 43 të Rregullores, i cili përcakton se vendimi i Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose Gjykatës pas votimit nuk mund të ndryshohet, por veçse mund të saktësohet, plotësohet ose ndreqen gabime në shkrim ose ndonjë pasaktësi e dukshme e lejuar në to.

9. Në kuptim të këtyre dispozitave, kërkuesi, pasi është njohur me vendimin nr. 224/2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për saktësimin dhe plotësimin e atij vendimi.

10. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit të pasqyruar në pikën 7.1 të pretendimeve, sipas të cilit në paragrafin 2, rreshti 6, të vendimit nr. 224/2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, emërtesa “Kolegji Penal” është referuar në mënyrë të gabuar, pasi çështja në fjalë është e natyrës civile, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se përmbajtja e këtij paragrafi është si vijon: *“Me pretendimin se ky vendim i ka njohur atij pronësinë mbi banesën, kërkuesi u është drejtuar gjykatave me procese të ndryshme, ndër të cilat edhe ai me objekt konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 314, datë 11.04.1994 të KKKP-së, në favor të trashëgimlënësit të të paditurve, Xh.K., padi e cila është rrëzuar nga vendimet nr. 8996, datë 03.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 2610, datë 10.12.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe për të cilën Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1709, datë 11.04.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit.”*. Nisur nga fakti se çështja në fjalë është e natyrës civile, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se në këtë paragraf të vendimit është bërë një gabim në shkrim në lidhje me fjalën “Penal”, i cili nevojitet të ndreqet për këtë shkak.

11. Ndërsa për sa i përket pretendimeve të tjera, në referim të objektit dhe përmbajtjes së kërkesës, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ndonëse kërkuesi e ka paraqitur atë në kuptim të nenit 80 të ligjit nr. 8577/2000, në thelb ai kundërshton qëndrimin e mbajtur nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe mënyrën e trajtimit të pretendimeve të tij në vendimet nr. 177/2022, nr. 119/2023 dhe nr. 224/2023. Pretendimet e kërkuesit janë përsëritje e pretendimeve të paraqitura

prej tij në kërkesat e mëparshme drejtuar Gjykatës, të cilat janë marrë në shqyrtim dhe u është dhënë përgjigje me këto vendime të Mbledhjes së Gjyqtarëve. Ato kanë të bëjnë me pretendimin kryesor që lidhet me cenimin e së drejtës së pronës për shkak të vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe veprimeve të institucioneve, por edhe me procedurën e ndjekur nga momenti i regjistrimit të kërkesave në Gjykatë deri në vendimmarrje nga ana e Mbledhjes së Gjyqtarëve, si dhe paanshmërinë e disa anëtarëve të saj. Pavarësisht argumenteve të ngritura në kërkesë, vendimmarrja e Mbledhjes së Gjyqtarëve, si dhe procedura e ndjekur prej saj në përputhje me parashikimet e ligjit organik dhe Rregullores nuk mund të vihen në diskutim ose të bëhen objekt kontrolli as prej vetë Gjykatës, pasi edhe vendimet e dhëna në fazën e shqyrtimit paraprak nga Mbledhja e Gjyqtarëve kanë natyrë përfundimtare (*res judicata*).

12. Për sa më sipër, për sa kohë nuk ndodhemi përpara rasteve të parashikuara në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe në nenin 43 të Rregullores, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuesi nuk legjitimohet për pretendimet e tjera të paraqitura në kërkesat e tij.

13. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson të ndreqë gabimin material në paragrafin 2 të vendimit nr. 224/2023 të saj, ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesit, ajo çmon se kërkesa nuk i plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31, 31/a dhe 80, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.
2. Pranimin e kërkesës për saktësimin e paragrafit 2 të vendimit nr. 224, datë 31.10.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, i cili bëhet si vijon: “*Me pretendimin se ky vendim i ka njohur atij pronësinë mbi banesën, kërkuesi u është drejtuar gjykatave me procese të ndryshme, ndër të cilat edhe ai me objekt konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 314, datë 11.04.1994 të KKKP-së, në favor të trashëgimlënësit të të paditurve, Xh.K., padi e cila është rrëzuar nga vendimet nr. 8996, datë 03.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 2610, datë 10.12.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe për të cilën Kolegji*

Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1709, datë 11.04.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit.”.

3. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit nr. 224, datë 31.10.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.